



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr 2091 Prot

Vlorë, 20.02.2023

PROJEKT - VENDIM

Nr. _____ datë _____ 2023

“PËR MIRATIMIN E DOKUMENTAVE TË PUNËS, PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN”

Këshilli i Bashkisë Vlore, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Ndhimes dhe Shërbimit Social “**PËR MIRATIMIN E DOKUMENTAVE TË PUNËS, PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN**” bazuar në dispozitat: Ligji nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligji 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore, funksionimin, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të organeve përkatëse"; Ligjin nr. 18/2017, “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve”; Vendim nr.866, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020-2023, dhe planit të veprimit në zbatim të saj”; Vendim nr.706 më datë 09.09.2021 “Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020– 2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij; Vkm nr.518, datë 4.9.2018 për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar; Udhëzim, Nr. 911, datë 27.12.2018 “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore;

V E N D O S A:

1. Miratimin e dokumentave të punës, për ofrimin e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen bashkalidhur:

- 1) dokumenti mbi protokollin e punës së SHMFF.
- 2) dokumenti mbi kodin e sjelljes.
- 3) dokumenti mbi politikat e mbrojtjes.
- 4) dokumenti mbi mekanizmin e llogaridhënies së SHMFF (monitorim&vlerësim).
- 5) dokumenti mbi procedurat e ofrimit të shërbimit kujdesit në familje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

- 6) dokumenti mbi procedurat e ofrimit të klasave të prindërimit.
- 7) dokumenti për monitorimin e shërbimit të Kujdesit Alternativ Profesional.
- 8) dokumenti mbi mekanizmat e monitorimit dhe supervizimit.
- 9) dokumenti mbi miratimin e informuar.
- 10) dokumenti mbi marrëveshjen tip ofrues shërbimi-përfitues.
- 11) dokumenti mbi rregulloren e administrimit e bankës së ushqimeve, veshmbathjeve dhe mjeteve higjienosanitare.

2. Ngarkohen Drejtoria e Ndihtes dhe Shërbimit Social dhe Shërbimi Mbështetës për Fëmijën dhe Familjen për zbatimin e këtij vendimi.

3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore").

Drejtoreshë e Përgjithshme e Drejtorisë

Juridike dhe Burimeve Njerëzore

Laura Brinja

Drejtoreshë e Ndihtes dhe Shërbimit Social

Irena Stasa

Drejtoreshë Juridike

Sonela Haxhiraj

Përgjegjëse Projekti

Stela Mertiraj

KRYETARI

Dritan Leli





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORE
DREJTORIA E NDIHMËS DHE SHËRBIMIT SOCIAL

RELACION

***MBI MIRATIMIN E DOKUMENTAVE TË PUNËS, PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE
MBËSHTETËSE PËR FËMIJËT DHE FAMILJEN BASHKIA VLORE.***

Në zbatim të Planit Social Vendor 2019-2022 dhe Planit Kombëtar të Deinsitucionalizimit 2020-2022 Bashkia Vlore me mbështetjen e Fondit Social 2021 të akorduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe në partneritet me Shoqatën Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS, prej vitit 2021 ka ngritur Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen e cila është një strukturë në varësi të Drejtorisë të Ndihmës dhe Shërbimit Social Bashkia Vlore, miratuar në Këshillin Bashkiak Nr 37. Datë 27.05.2021. **“MIRATIMIN E NGRITJES SË SHËRBIMEVMBËSHTETËSE PËR FËMIJËN DHE FAMILJEN NË KUADËR TË TRANSFORMIMIT TË SHËRBIMEVE REZIDENCIALE NË SHËRBIME ME BAZË KOMUNITARE.”**

Shërbimet Mbështetëse për Fëmijët dhe Familjen me bazë komunitare mbështeten në legjislacionin në fuqi: Ligjin nr.121/2016 "Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë"; Ligji 139/2015 "Për Vetqeverisjen vendore, funksionimin, kompetencat, të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe të organeve përkatëse"; Ligjin nr. 18/2017, "Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve"; Vendim nr.866, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020-2023, dhe planit të veprimit në zbatim të saj"; Vendim nr.706 më datë 09.09.2021 "Për miratimin e Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit 2020– 2022, dhe të planit të veprimit për zbatimin e tij; Vkm nr.518, datë 4.9.2018 për shërbimet e kujdesit shoqëror komunitar e rezidencial, kriteret, procedurat për përfitimin e tyre dhe masën e shumës për shpenzime personale për përfituesit e shërbimit të organizuar; Udhëzim, Nr. 911, datë 27.12.2018 "Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinore";. etj.

Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen janë një ndërthurje midis shërbimeve parashoqërore, shërbimeve në qendrat komunitare, shërbimeve të specializuara dhe shërbimeve të emergjencës dhe funksionojnë në përputhje me standardet e shërbimeve komunitare shumëdisiplinare.

Ngritja e këtij shërbimi ka qënë në përputhje me realitetin dhe nevojat e komunitetit në Bashkinë Vlore, duke ofruar shërbime të integruara për zhvillimin e fëmijëve, aftësive të tyre psikosociale dhe edukative si dhe mbështetje të specializuar për fuqizimin e prindërve dhe familjeve.

Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet shoqatës Nisma për Ndryshim Shoqëror ARSIS dhe Bashkisë Vlore e lidhur me datë 27.05.2021 me nr.prot 8226/1 prot, për zbatimin e projektit “Qendra e Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen me bazë komunitare” (Parandalimi i institucionalizimit dhe deinstitucionalizimi i fëmijëve nga Institucionet e Përkujdesit Shoqëror) me mbështetje të Fondit Social (2021-2023), bazuar në nenin 4 të marrëveshjes, sipas detyrimeve, palët kanë hartuar një paketë e plotë dokumentash si më poshtë:

1. dokumenti mbi protokollin e punës së SHMFF:

Protokolli i punës për SHMFF është një dokument që i shërben profesionistëve, pjesë e ekipit të Shërbimeve Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen dhe ka si qëllim përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

2. dokumenti mbi kodin e sjelljes :

Kodi i Sjelljes shërben si një udhërrefyese për veprimtaritë e përditshme në punë duke reflektuar standardin për sjellje të përshtatshme. Respektimi i këtyre standardeve do të interpretohet brenda kornizës së Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve. Kushdo që konstatohet se është në shkelje të Kodit do t’i nënshtrohet masave disiplinore, duke përfshirë largimin nga detyra, përfundimin e punës dhe/ose marrëveshjeve të tjera me SHMFF. Kodi i Sjelljes është i zbatueshëm nga të gjithë ata që ofrojnë shërbime pranë SHMFF.

3. dokumenti mbi politikat e mbrojtjes:

Shërbimet Mbështetëse për Fëmijën dhe Familjen sigurojnë mbrojtje për çdo fëmijë, të ri dhe familjet e tyre dhe përkrahjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rriturve dhe mirëqënies së tyre. Qëllimi i politikës së mbrojtjes dhe procedurave përkatëse është të rregullojë punën e SHMFF në mënyrë që fëmijët dhe të rriturit me të cilët vendoset kontakti (i drejtpërdrejtë ose jo) të jenë të mbrojtur; individëve t’u promovohet mirëqënia dhe veprimet e ndërmarra gjatë zbatimit të programeve apo aktiviteteve institucionale të mos shkaktojnë dëme tek ta.

4. dokumenti mbi mekanizmin e llogaridhënies së SHMFF (monitorim&vlerësim):

Monitorimit dhe vlerësimit shërben për të siguruar cilësinë dhe impaktin e një shërbimi për fëmijët, të rinjtë dhe familjet e tyre nëpërmjet mbledhjes së të dhënave dhe matjes së progresit të objektivave të përcaktuar.

5. dokumenti mbi procedurat e ofrimit të shërbimit kujdesit në familje:

Shërbimi i kujdesit në familje është një qasje tërësore e bazuar tek familja, duke synuar një zgjerim më të madh në kontekstin e zhvillimit të komuniteteve të qëndrueshme, pra në një qasje që merr karakter pro-aktiv.

6. dokumenti mbi procedurat e ofrimit të klasave të prindërimit:

Programi i prindërimit vë në qendër mirëqenien e fëmijës dhe adoleshentit përmes promovimit të një marrëdhënie të shëndetshme, mbështetëse, pranuese mes tyre dhe prindit. Nëpërmjet ndërgjegjësimit të prindërve për rolin e tyre, përballimit të shëndetshëm të stresit prindëror, informimin mbi praktikat pozitive të prindërimit dhe strategjitë e përshtatshme për mbështetjen e fëmijës dhe adoleshentit në përputhje me nevojat e tyre dhe moshën, synohet të reduktohet rreziku i abuzimit dhe i ndarjes së fëmijëve nga familja.

7. dokumenti për monitorimin e shërbimit të Kujdesit Alternativ Profesional:

Fëmijët e vendosur në kujdes alternativ kërkojnë mbikëqyrje të vazhdueshme. Moshë nuk është faktori i vetëm përcaktues për të gjykuar nivelin e mbikëqyrjes që kërkohet për një fëmijë të vendosur në kujdes alternativ profesional. PMF së bashku me kolegët nga SHMFF hartojnë dhe ndjekin në mënyrë rigoroze planin e mbikëqyrjes për mirëqenien e fëmijës si edhe për kujdesin e ofruar nga prindërit kujdestar profesional.

8. dokumenti mbi mekanizmat e monitorimit dhe supervizimit:

Mentorimi është një proces të mësuar, ku ndërtohet dhe zhvillohet një marrëdhënie ndihmuese mes mentoruesit dhe të mentoruarit. Ky proces synon përfundimin e arritjeve profesionale; mbështetja emocionale është një element kyç i këtij procesi. Përmes marrëdhënies mentoruese, i/e mentoruari/a zhvillon dhe mëson përmes përvojës së mentorëve me më shumë përvojë në fushat specifike të temave dhe çështjeve të trajtuara.

9. dokumenti mbi miratimin e informuar:

Miratimi i informuar është thelbësor për etikën që SHMFF ndjek në trajtimin e rasteve. Rastet kanë të drejtën për të marrë informacion dhe për të bërë pyetje rreth shërbimeve që do tu ofrohen dhe si do të bëhen pjesë e këtyre shërbimeve, në mënyrë që të gjitha vendimet e marra të jenë të dakordësuara prej tyre.

10. dokumenti mbi marrëveshjen tip ofrues shërbimi-përfitues:

Marrëveshja Tip që lidhet ndërmjet shërbimofruesit SHMFF në Bashkinë Vlorë dhe përfituesit të shërbimeve sic janë anëtarët madhorë të familjeve që bëhen pjesë e programeve mbështetëse të SHMFF synon të vendosë institucionalizimin e marrëdhënies ndërmjet palëve si dhe të përcaktojë qartë rolin dhe përgjegjësitë e secilit partner të përfshirë në këtë marrëveshje.

11. dokumenti mbi rregulloren e administrimit e bankës së ushqimeve, veshmbathjeve dhe mjeteve higjienosantare.

Në zbatim të Urdhërit nr.548, datë 01.10.2020 të Ministres së MSHMS "Për ngritjen dhe funksionimin e Komitetit Drejtues për zbatimin e planit kombëtar të deinstitutionalizimit 2020 - 2022", pika 1.3, mbi funksionet dhe detyrat kryesore të Komitetit Drejtues, Rishikimi dhe ndjekja e miratimit të modeleve të reja të shërbimeve, si dhe të gjithë dokumentave të tjerë të zhvilluar, në kuadër të zbatimit të Planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit, Bashkia Vlore me me shkresë nr.7226, dt.24.08.2022, ka dërguar për konsultim, diskutim dhe miratim nga Komitetit Drejtues, i ngritur për zbatimin e planit Kombëtar të Deinstitutionalizimit në MSHMS, të gjithë paketës së plotë të dokumentave të sipërcituar. Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, me shkresë 3382/1 dt.05.12.2022 ka shprehur dakordësimin në parim të dokumentacionit dhe ka kërkuar në vijim që kjo paketë të miratohet edhe në Këshilli Bashkiak.

Për sa më sipër kërkojmë bashkëpunimin tuaj në miratimin e paketës së plotë të dokumentave që kanë si qëllim sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të fëmijëve dhe familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror.

Drejtoresha e Ndihmes dhe Shërbimit Social

Irena Stasa

Përgjegjëse Projekti

Stela Mertiraj